



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
-AUTORITETI I KONKURENCËS-  
KOMISIONI I KONKURENCËS**

---

**V E N D I M**

**Nr.279, datë 22.04.2013**

**“Mbi**

**autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V”**

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

- Znj. Lindita Milo (Lati) Kryetar
- Znj. Rezana Konomi Zv. Kryetar
- Znj. Servete Gruda Anëtar
- Z. Koço Broka Anëtar
- Znj. Iva Zajmi Anëtar;

Në mbledhjen e tij të datës 22.04.2013, shqyrtoi çështjen me :

**Objekt:** Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V.

**Baza ligjore:** Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, neni 24, shkronja d, nenet 10-12, dhe neni 16, në veçanti Kreu III “Përqendrimet e ndërmarrjeve” nenet 53-64, Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”, Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit ” dhe Formulari i Thjeshtuar “Për njoftimin e përqendrimit”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të raportit mbi njoftimin e përqendrimit Euromax Sh.p.k me CM Balkans B.V dhe relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm,

## V Ë R E N S E:

### 1. Transaksioni dhe përqendrimi

Përqendrimi realizohet në bazë të 'Kontratës për shit-blerje kuotash' të lidhur më datë 6 Mars 2013, ndërmjet palëve ("CM Balkans B.V" në cilësinë e blerësit dhe "Balfin Sh.p.k" në cilësinë e shitësit") me qëllim përfundimin e kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nga shoqëria CM Balkans B.V nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave.

Ky transaksion i cili ndryshon cilësinë e kontrollit në ndërmarrjen target (Euromax Sh.p.k) në formën e transferimit të kuotave nga shitësit te blerësi përbën një përqendrim në bazë të nenit 10 pika 1) , shkronja b) e Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës", i ndryshuar. Gjithashtu përqendrimi i njoftuar përmbush edhe kushtet e nenit 12 të Ligjit përsa i përket xhirove (neni 12/1).

### 2. Palët në transaksion

- ❖ **CM Balkans B.V** në cilësinë e **blerësit**, me seli në adresën: PrinsBernhapplein 200, 1097JB, Amsterdam, Hollandë. Shoqëria ka si objekt veprimtarie: themelimin, blerjen, zotërimin, pjesëmarrjen, tjetërsimin, menaxhimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, të shoqërive dhe ndërmarrjeve që operojnë në aktivitete të shitjes me pakicë të produkteve ushqimore dhe jo-ushqimore në territoret e Shqipërisë, Sllovenisë, Serbisë, Bosnie Hercegovinës, ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Malit të Zi dhe Bullgarisë etj.
- ❖ **Balfin Sh.p.k**, në cilësinë e **shitësit**, me seli në adresën: Rruga "Papa Gjon Pali II, ABA Business Centre, kati 12, Tiranë. Shoqëria kryen aktivitet në fushën e (i) import- eksportit, shitjes me shumicë dhe pakicë të produkteve tekstile, veshjeve të të gjitha llojeve; (ii) shitjen me shumicë dhe pakicë të mallrave industrialë dhe ushqimorë; (iii) tregtimi i artikujve të ndryshëm; (iv) importin dhe eksportin , shitjen me shumicë dhe pakicë të pajisjeve elektronike, lëndë të parë për industrinë, materiale ndërtimi e hidrosanitare, pajisje zyresh kancelari, pjesë këmbimi auto e makineri të çdo lloji, pajisje teknologjike , etj;
- ❖ **Euromax Sh.p.k**, në cilësinë e ndërmarrjes **target** është një shoqëri e themeluar dhe funksionon sipas legjislacionit shqiptar, me seli në Kashar, Tiranë. Objekti i kësaj shoqërie ishte importi eksporti; tregtimi i artikujve të ndryshëm (kryesisht ushqime, pije, duhan), servis paisjesh elektronike dhe elektroshtëpiake, automjetesh etj; transport të mallrave dhe udhëtarëve urbanë, ndërurbanë dhe ndërkombëtarë.

### 3. Xhiro për vitin 2012

- Xhiro totale në **tregun ndërkombëtar** është **XXXLekë**, ku:

- CM Balkans B.V. : = XXX lekë
- Delhaize Group : XXXX Euro = XXXX lekë
- Balfin sh.p.k.së bashku me shoqëritë e lidhura XXX lekë
- Xhiro totale në **tregun e brendshëm**: është **XXX Lekë**, ku:
  - CMB Albania sh.p.k. = XXXX lekë
  - Delhaize Albania sh.p.k. = XXXX leke
  - Balfin së bashku me shoqëritë e lidhura = XXXX leke (Balfin sh.p.k. si shoqëri e vetme = XXXX lekë)

Palët në transaksion plotësojnë kriteret e xhiros së përcaktuar në nenin 12, pika 1 të Ligjit nr.9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar dhe si rrjedhojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

## **4. ANALIZA E KONKURRENCËS**

### **4.1 Tregu përkatës**

*Tregu përkatës i produktit* do të përkufizohet si tregu i shitjes me pakicë i produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit që kanë qëllim furnizimin ditor dhe të rastit të familjeve nëpërmjet formateve të dyqaneve të paspecializuara si dyqanet në afërsi të lagjes, supermarketeve dhe hipermarketeve.

*Tregu përkatës gjeografik*: ky treg përfshin hapësirën ku tregtohen produktet apo shërbimet e ofruara të përcaktuara në tregun e produktit. Për vlerësimin e këtij përqendrimi, tregu përkatës gjeografik është konsideruar rajoni gjeografik ku konsumatorët kanë akses pa kosto shtesë transporti në rrjetet e dyqaneve Carfour dhe Euromax duke përfshirë Tiranën, Durrësin, Fierin, Vlorën dhe Elbasanin.

### **4.2 Përqendrimi i tregut**

Tregu i shitjes me pakicë i ushqimeve dhe mallrave të konsumit është i formuar kryesisht nga dyqane të mesëm e të vegjël dhe të pavarur nga njëri tjetri, duke patur kështu karakteristikat e një tregu kryesisht tradicional.

Ndërkohë, tregtia me pakicë në format modern (supermarkete, hipermarkete etj) ka marrë zhvillim vetëm gjatë viteve të fundit. Kështu nëse do t'i referoheshim të dhënave të mundësuar nga palët në formularin e njoftimit të përqendrimit, ajo përfaqëson jo me shume se 9% të tregut me pakicë të këtyre produkteve dhe mallrave.

Përqendrimi sjell ndryshime në rritje në pjesën e tregut që zë aktualisht shoqëria CM Balkans B.V., por nuk sjell ndryshime të mëdha në strukturën e tregut pas përqendrimit. Pas përqendrimit shoqëria CMB Albania sh.p.k. bëhet konkurrenti kryesor në këtë treg me 5.1% të tij.

Për shkak të strukturës që ka tregu i shitjes me pakicë në Shqipëri (numrit të madh të dyqaneve të vogla dhe të mesme dhe pavarësisë nga njëri tjetri), por edhe të përqindjes së tregut që zotërojnë pjesëmarrësit në të, mundësitë e tyre për të rritur çmimet në mënyrë të njëanshme janë të limituara. Gjithashtu, për të njëjtat arsye, krijimi apo zhvillimi i praktikave të përbashkëta veçanërisht për fiksimin e çmimit nga pjesëmarrësit në treg do të ishte i pamundur.

### **4.3 Vlerësimi i efijences se përqendrimit**

Nëpërmjet përfutimit të kontrollit të drejtëpërdrejtë të Euromax Sh.p.k nga shoqëria CM Balkans B.V., kjo e fundit synon të shtrijë dhe zgjerojë aktivitetin e saj nëpërmjet filialit të saj CMB Albania sh.p.k në këtë treg duke shfrytëzuar pozitën aktuale të vetë shoqërisë target.

Përmes këtij përqendrimi, blerësi synon të zgjerojë veprimtarinë e tij në fushën e tregtisë me pakicë të mallrave ushqimorë dhe jo-ushqimorë në territorin e Shqipërisë.

Pala njoftuese shprehet se do të ketë një impakt pozitiv të përqendrimit të realizuar si përse i përket performancës financiare ashtu dhe përfitime për konsumatorët. Pas përqendrimit pritet të rriten shitjet dhe të përmirësohen kushtet e furnizimit dhe shumëllojshmëria e produkteve.

**Si konkluzion, përqendrimi i realizuar nuk shfaq shenja të kufizimit të konkurrencës në treg ose në një pjesë të tij në veçanti, si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese.**

### **PËR KËTO ARSYE**

Në bazë të nenit 24, shkronja d, dhe nenit 56 pika 1, të Ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për mbrojtjen e konkurrencës":

### **VENDOSI:**

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.p.k tek shoqëria CM Balkans B.V.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### KOMISIONI I KONKURRENCËS

**Servete GRUDA**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Koço BROKA**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Iva ZAJMI**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Rezana KONOMI**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Zv. Kryetar**

**Lindita MILO (LATI)**

**K R Y E T A R**

### MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës **Nr.279, datë 22.04.2013** “Mbi Autorizimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfutimit të kontrollit të shoqërisë **Euromax Sh.p.k** nëpërmjet transferimit të 100% të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria **Balfin Sh.p.k** tek shoqëria **CM Balkans B.V**” kam mbajtur qëndrimin **KUNDER**, me arsyetimin e mëposhtëm :

I. Çështja e përqendrimit të **EUROMAX DELHAIZE Albania Sh.P.K** nga **CM Balkans B.V** ka si karakteristikë se ajo paraprihet nga përqendrimi i **Euromax Sh.p.k** pesë vjet më parë nga Autoriteti i Konkurrencës.

Nga minutazhi i mbledhjes së Komisionit të Konkurrencës dhe Memo e Drejtores së Kabinetit drejtuar Sekretares së Përgjithshme në Korrik 2008 midis të tjerash thuhet :

“Komisioni u shpreh qartë se cilësia e Raportit të Grupit të punës prezantuar Komisionit të Konkurrencës “është shumë e dobët”.

Në mbledhje theksua :

a) Të shprehet qartë nga pikpamja juridike dhe ekonomike identiteti i palëve (blerëse dhe shitëse)

b) Të shprehet qartë transaksioni dhe elementët ekonomike të transaksionit “...çfarë është shitur konkretisht”. Cilësia e punës së raportit është shumë e dobët. Për këtë ju tërheq vërejtje. **Duhet analizë më reale e gjerave**”

Ky rast përqendrimi kishte të bënte me përfitimin e plotë të kapitalit të shoqërisë **Euromax sh.p.k** , nga **Delta Maxi d.o.o** dhe **Weakstead Real Estate B.V**.

Në vitin 2011 me vendim Nr. 188 Datë 26.05.2011 të Komisionit të Konkurrencës është autorizuar përqendrimi i realizuar nëpërmjet përfitimit të plotë me anën e blerjes të 100 % të kapitalit të **DELTA MAXI d.o.o, Serbia** ( “ **Delta Maxi**” ), e cila kish filialin e saj në pronësi 100 % “**Euromax “ Sh.p.k** nga shoqëria **Delhiaze Group- DELHAIZE “The Lion” Nenderland B.V**; një shoqëri e krijuar në Hollandë.

Në Shkurt 2013 , nëpërmjet vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 268, datë 08.02.2013. “Mbi Autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Delhaize Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100 % të kuotave të kësaj të fundit nga Lion Real Holding s.a.r. dhe Delhaize Serbia d.o.o tek **Balfin Sh.p.k** .

Me Raportin e Sekretariatit “Përfitimi i kontrollit të vetëm të Shoqërisë Euromax Sh.pk nga Shoqëria Ballkan B.V. është prezantuar dhe Draft Vendimi “Mbi autorizimin e përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100 % të kuotave të kësaj të fundit na shoqëria Balfin Sh.p.k tek Shoqëria CM Ballkans B.V.

**Pra shoqëria target është shoqëria Euromax sh.p. k .**

Kjo shoqëri , Euromax Sh.p.k është shitur tek DELTA MAXI d.o.o, Serbia ( “ Delta Maxi” në vitin 2008 për XXX milion Euro, kur vlera e Aseteve në fund të vitit 2007 ishte XXX mijë lekë, dhe kishte një rrjet prej 12 supermarketesh, me një inventar prej XXX mijë lekë.

Ndërsa tani ndërmarrja “Euromax Sh.p.k” shitet nga Shoqëria Balfin tek Shoqëria CMB Albania Sh.p.k për XXX milion Euro ose 5.96 herë më pak, dhe me kursin 140 Lek/Euro ne lek vlera e shitjes është XXX mijë lekë. Kjo në një kohë kur vlera e asetëve të “Euromax Sh.p.k në fund të vitit 2012 ishte XXX mije lekë , me një rrjet prej 23 supermarketesh kur vetëm vlera e inventarit është XXX mije lekë ose XXX Euro.

Kjo do të thotë se me një shumë prej XXX mijë lekë janë blerë/shitur asete materiale afatgjata dhe asete të tjera me vlerë prej XXX mijë lekë.

II. Është e tepërt të thuhet se të dhëna të tilla, shtyjnë dhe bëjnë të nevojshme dhe të domosdoshme një shqyrtim më të plotë qoftë edhe formal, mbi besueshmërinë e vlerave të bilancit dhe të pasqyrave të tjera financiare, në se ato paraqitin në mënyrë korekte realitetin.

Ky është një obligim i Autoritetit të Konkurrencës, dhe Institucioneve të tjera publike i cili rrjedh edhe nga kërkesat e Formularit të Njoftimit të Thjeshtuar të Përqëndrimit seksioni 9 ku kërkohet deklarimi : “Pala ose palët njoftuese deklarojnë që sipas njohurive dhe besimit të tyre të plotë, informacioni i dhënë në këtë njoftim është i vërtetë, i saktë dhe i plotë; se janë dhënë kopje të vërteta dhe të plota të dokumenteve të kërkuara nga Formulari . Të gjitha vlerësimet e dhëna identifikohen si të vërteta dhe janë vlerësimet e tyre më të mira të mbështetura mbi faktet dhe se të gjitha mendimet e shprehura janë të sinqerta”.

Cdo shqyrtimi i përqëndrimeve fillon nga presupozimi se të dhënat janë të vërteta konform realitetit. Të dhënat e mësipërme flasin se ato duhen shqyrtuar duke vlerësuar fillimisht **nga pikpamja formale** në se ato paraqitin në mënyrë korrekte realitetin.

Dokumentacioni i paraqitur pranë Autoritetit të Konkurrencës për “Pasqyrat financiare viti 2012, të shoqërisë DELHAIZE Albania Sh.pk” është noterizuar se është i njëjtë me origjinalin.

Natyrisht kjo nuk ezauron çështjen në se këto të dhëna janë një paraqitje korrekte e realitetit.

**Por kjo nuk përjashton dhe nuk duhet të përjashtojë për gjykimin tim si komisioner i Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës, analizën formale mbi besueshmërinë e vlerave të pasqyrave financiare ( 1) Bilanci kontabël- Pasqyra e gjendjes pasurore, 2) Pasqyra të Ardhura Shpenzime, 3) Shënime Sqaruese, (pa u**

**ndalur në Raportin e Auditimit) dhe mbi efektin që ka saktësia e tyre në konkurrencën e tregut përkatës sidomos në kushtet kur ato janë paraqitur nën siglën DRAFT.**

III. Të dy ndërmarrjet që i nënshtrohen kërkesës për Autorizim Perqëndrimi nga Komisioni i Konkurrencës dhe operojnë në tregun përkatës të produktit të përkufizuar si “tregu i shitjes me pakicë i produkteve ushqimore dhe mallrave të konsumit që kanë qëllim furnizimin ditor dhe të rastit të familjeve nëpërmjet formative të dyqaneve të paspecializuara si dyqanet në afërsi të lagjes, supermarketeve dhe hipermarketeve”, kanë si karakteristikë se jo vetëm për vitin 2012 dalin me humbje. Të dy ndërmarrjet rezultojnë me humbje që nga viti 2007 dhe në vazhdim. **Euromax** ka 6 vite që nga viti 2007 që rezulton me humbje, ndërsa **CM Balkans B.V** për dy vjet. Shtyrë nga sa më sipër u ndala vetem në shqyrtimin formal mbi besueshmërinë e të Dhenave të Pasqyrave Financiare (shih Aneks nr 1)

Nga një “lexim “ i tyre, rezulton se për ndërmarrjen **CM Balkans B.V** nga shqyrtimi formal i pasqyrës të të Ardhurave dhe Shpenzimeve, nuk paraqitet ndonje shenjë e dukshme për mos paraqitejen korrekte të realitetit. Humbjet janë reflektuar në pakësimin e kapitalin e vet fillestar.

Por ndërkohë shumica e detyrimeve afatshkurta dhe aftgjata rezultojnë me e madhe se sa ajo e aktiveve.

Por nuk mund të thuhet e njëjta gjë për ndërmarrjen Euromax gjatë periudhës 2007-2012, e cila për gjatë gjithë kësaj periudhe ka dalë me humbje dhe nuk ka falimentuar as juridikisht as realisht.

Më konkretisht:

Në fund të vitit 2007 gjendja pasurore e ndërmarrjes Euromax paraqitet si më poshtë:

Totali i aktiveve = Kapitali e veta + (Totali i detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata)

XXX mijë lekë = XXX mijë lekë + (XXX mijë lekë + XXX mijë lekë)

Ndërsa në fund të vitit 2011 e 2012 (në dokumentin nënvizuar Draft) gjendja pasurore e ndërmarrjes Euromax paraqitet si më poshtë:

Totali i aktiveve = Kapitali e veta + (Totali i detyrimeve afatshkurta dhe afatgjata)

Për vitin 2011

XXX mijë lekë = XXX mijë lekë + (XXX mijë lekë + XXX mijë lekë)

Për vitin 2012

XXX mijë lekë = XXX mijë lekë + (XXX mijë lekë + 0)

Që nga viti 2007 e në vazhdim, kjo ndërmarrje ka rezultuar me humbje.

IV. Ndërkohë është e njohur lidhja që ekziston mbi bazën teorike të shkencës ekonomike në tërësi por dhe kontabilitetit në veçanti midis Pasqyrës të të Ardhurave dhe Shpenzimeve nga njera anë dhe Bilancit-kapitalit të vet nga ana tjetër.

Sipas shkencës Ekonomike në kushtet kur një ndërmarrje del me fitim ai mundëson në rritjen e kapitalit të vet. Por ndërkohë nëse ndërmarrja del me humbje ajo çon në uljen, pakësimin e kapitalit të vet.

Krejt ndryshe ka ndodhur me kapitalin e vet të Ndërmarrjes Euromax nga viti 2007 në vitin 2011. Megjithatë çdo vit kjo ndërmarrje ka dalë me humbje, bazuar në të dhenat e Pasqyrave Financiare të kësaj ndërmarrje të paraqitura në mënyrë të përmbledhur në Aneksin nr.1 bashkëlidhur, rezultoi se kapitali i vet është rritur nga XXX mijë lekë në , në XXX mijë lekë, në një kohë kur huat dhe kredite afatgjata kanë rënë nga XXX mijë lekë në fund të vitit 2007, në XXX në fund të vitit 2012.

Nisur nga kjo situatë Pasqyrat Financiare të ndërmarrjes Euromax , kërkojnë një hetim të plotë nga ana e Autoritetit të Konkurrencës duke evidentuar dhe efektet që ka kjo paraqitje në konkurrencën dhe për konkurrentët në tregun përkatës.

Në këto rrethana del jo vetëm e nevojshme por dhe e domosdoshme shqyrtimi dhe hetimi më i plotë i Pasqyrave Financiare në se ato bëjnë një paraqitje korrekte të realitetit dhe në çfarë shkalle situata reale dëmton konkurrencën në tregun përkatës.

Kryqezimi i të dhënave të pasqyrës të të ardhurave dhe Shpenzimeve dhe Bilancit në vitet përkatëse flasin se zori se kemi të bëjmë me një paraqitje korrekte të realitetit.

Nga ana tjetër Euromax ka për 6 vjet që del me humbje, ndërsa ndërmarrja tjetër pjesë e përqëndrimit **CM Balkans B.V** ka dy vjet me humbje dhe detyrimet e saj janë më të mëdha nga asetet-aktivet.

Në këto kushte, mbi këtë bazë-shqyrtimin formal të Pasqyrave Financiare, në mbledhjen e Komisionit të Konkurrencës datë 15.04.2013 , mbajta qëndrimin:

1 Raporti “Përfitimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë Euromax Sh p.k. nga CM Ballkans B.V,” nuk miratohet nga ana ime si Komisioner.

2. Së dyti Pasqyrat financiare përkatëse t’u dërgohen institucioneve publike që merren me certifikimin i bilanceve.

3.Në kushtet kur pasqyrat financiare të dy ndërmarrjeve pjesë e përqëndrimit janë me humbje autorizimi nga ana e Komisionit të Konkurrencës të jetë me kusht .

V. Raporti i Grupit të Punës “Përfitimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë Euromax Sh p.k. nga CM Ballkans B.V,” është kthyer për rishqyrtim dhe plotësim.

Me Relacionin e datës 19.04.2013 Mbi përqëndrimin “Autorizimi i përqëndrimit të realizuar nëpërmjet përfitimit të shoqërisë Euromax Sh.p.k nëpërmjet transferimit të 100 % të kuotave të kësaj të fundit nga shoqëria Balfin Sh.pk tek shoqëria CM Ballkan B. V u ridërgua Raporti i ndryshuar “. Përfitimi i kontrollit të vetëm të shoqërisë Euromax Sh.P.K nga shoqëria CM Ballkan B.V” , përgatitur nga grupi i punës konfirmuar nga Drejtori i Mbikqyrjes Tregut duke i kërkuar Komisionit të Konkurrencës miratimin e këtij përqëndrimi.

Në thelb ky relacion por edhe Raporti mbi të cilin është mbështetur, në fakt janë një copy-past i shkresave të dërguara nga pala njoftuese e blerjes se Euromaksit.

Por nuk ka analizë nga ana e sektorit të përqëndrimit , shqyrtim dhe vlerësim i dokumentave të dërguar më parë por dhe pas 15.04.2013.

Mjafton që të mbahet parasysh se i ashtuquajtur plan biznesi i përqëndrimit i paraqitur nga pala njoftuese nuk është në thelb një plan biznesi i efekteve të përqëndrimit nëpërmjet përfitimit të kontrollit edhe të ndërmarrjes Euromax nga CM Ballkan B.V, por vetëm një pasqyrë e ndërmarrjes CM Ballkan B.V si për vitin 2012 por dhe me pas. Mjafton të mbajmë parasysh se Plan Biznesi paraqitet CMB Albania Sh.p.k-Plan biznesi



2013-2018, dhe nuk prezanton plan biznesin e përqëndrimit . Për vitin 2012 Shitjet Neto të tij janë XXX milion Euro, aq sa janë shitjet neto të mallrave të paraqitura në bilancin e kesaj ndermarrje prej XXX milion lek.

Pra nuk kemi te bejme me nje plan biznesi që prezanton efektet e përqëndrimit

Në këto kushte nuk miratoj as Raportin as Draft Vendimin e paraqitur per shqyrtim nga Komisioni, ndërkohë nuk jam dakort për Autorizmin e këtij përqëndrimi duke dhënë votën KUNDËR.

Mbështetur në shenjat e trajtuara me sipër lidhur me besueshmerinë e vlerave të Pasqyrave Financiare për paraqitjen korrekte të realitetit, Autoriteti i Konkurrences të kalojë në një hetim të thelluar të këtij përqëndrimi, duke u paraprirë nga dërgimi për çertifikim nga Institucionet Publike Certifikuese të Bilanceve, duke njoftuar dhe Qeverinë.

Komisioner  
Koço Broka